

Prot. 2211/227 K (e-k)

Datë, 22/11/2022, Tiranë

Lënda: *Partia Fryma e Re Demokratike*

Gjetjet nga monitorimi i KRIIK mbi aktivitetin dhe raportimin

financiar të fushatës zgjedhore të vitit 2021!

Përshëndetje,

Në zbatim të kërkesës së Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 3.11.2022 për t'ua përcjellë gjetjet e Raportit të KRIIK-ut Partive Politike si dhe duke përjashtuar gjetjet që tashmë janë përfshirë në raportin e përgatitur nga KQZ-ja, ju ridërgojmë në formë të përmbledhur dhe të personalizuar se *lidhur me subjektin FRD, KRIIK ka konstatuar se:*

- *evidentohet 1 zyrë zgjedhore e padeklaruar;*

- *1 kandidat ka kryer pagesa për reklamë politike në Facebook dhe Instagram, por nuk ka dorëzuar raport vetëdeklarimi në KQZ;*

- *mungon bilanci i aseteve dhe detyrimeve.*

Lidhur me numrin e zyrave zgjedhore

Nga monitorimi i bërë prej vëzhguesve të KRIIK rezulton 1 zyrë zgjedhore e hapur nga ky subjekt. Nga raportet e monitoruesve të KQZ-së rezultojnë 0 zyra zgjedhore të hapura nga ky subjekt. Në raportin e vetëdeklarimit ky subjekt ka deklaruar 0 zyra zgjedhore të hapura për zgjedhjet e datës 25 prill 2021.

Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen koordinatat e vendndodhjes, brandimi ose jo me emër kandidati i zyrës zgjedhore, si dhe foto përkatëse.

Vendndodhja	Bashkia	Partia	Kandidati/ja	Foto
41.311274, 19.449164	Durrës	FRD - Partia Fryma e Re Demokratike		https://drive.google.com/file/d/1G5HhDzuEtrq7d6IAfZ5QZ2dEpShkJl2/view?usp=share_link

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania

Lidhur me shpenzimet e kandidatëve të FRD për reklamë politike në Facebook dhe Instagram

Kandidatja e FRD znj. Silva Hasaj për faqen në *Facebook* të së cilës është paguar shuma 42,436 lekë, në raportin e vetëdeklarimit nuk ka përfshirë asnjë shpenzim për këtë zë.

Lidhur me bilancin e asetëve dhe detyrimeve

Sipas komunikimit shkresor me KQZ-në rezulton se FRD nuk ka dorëzuar bilancin e asetëve dhe detyrimeve të partisë politike për periudhën nga dekretimi i datës së zgjedhjeve deri në datën e zgjedhjeve (pra nga data 6 shtator 2020 – 25 prill 2021), në zbatim dhe kuptim të detyrimit ligjor sipas nenit 92/3 “*Deklarimi dhe publikimi*” pika ç të Kodit Zgjedhor.

Duke ju falënderuar edhe njëherë për mirëkuptimin dhe bashkëpunimin në vazhdimësi me ju,

Me konsideratë,

***Për* Koalicionin Për Reforma, Integrim
dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK)**

Premto Gogo

Address:

Rr. "Ymer Kurti",
Nd.4, H.2, Ap.3,
Nj.Adm.5,
Tirana

Mailingaddress:

P.O.Box. 2396
Tirana, 1001,
Albania